



PROCESVERBAL NGA MBLEDHJA E KOMISIONIT QENDROR TË ZGJEDHJEVE

Nr. 01

Datë: 16. 01. 2023. Ora: 13:30

Vendi: Selia e KQZ-së/ Prishtinë.

Kreshnik Radoniqi, kryetar i KQZ-së.

Anëtarët e KQZ: Sami Kurteshi, Alim Rama, Arianit Elshani, Sami Hamiti, Ilir Gashi, Ibrahim Selmanaj, Rifat Krasniq, Gordana Llaban, Čemailj Kurtiš, Fazli Stollaj.

Burim Ahmetaj, kryeshef i SKQZ.

Besnik Buzhala, drejtor i ZRCKFSP

Përkthyes: Argjina Misini; Jehona Cami

Procesmbajtës: Fehmi Ajvazi.

RENDI I DITËS

1. Hyrje: z.Kreshnik Radoniqi, Kryesues i mbledhjes së KQZ-së

-Shqyrtimi dhe miratim i procesverbalit të mbledhjes Nr. 41, 42 dhe 43/2022

2. Aktivitetet e SKQZ-së

3. Raport nga Zyra

-Miratimi i vendimit për ndarjen e Fondit për mbështetjen e subjekteve politike për vitin 2023.

4. Raportet e Këshillave të KQZ-së

• Këshilli për Operacione Zgjedhore

-Shqyrtimi dhe miratimi i Strategjisë për Edukim dhe Informimin e Votuesve në vitet jo Zgjedhore

-Shqyrtimi dhe miratimi i Planit të Punës së KQZ-së për vitin 2023

-Shqyrtimi dhe miratimi i projektit: Dita Globale e Zgjedhjeve, Agjendës dhe Ftesës

-Shqyrtimi dhe miratimi i Kalendarit të aktiviteteve për hartimin e Planit Strategjik 2023-2026

- **Këshilli për Çështje Ligjore**

Shqyrtimi dhe miratimi i kërkesës për zëvendësim të anëtarit të Kuvendit Komunal në Prishtinë dhe Suharekë

5. Të ndryshme

1. Hyrje: z. Kreshnik Radoniqi, Kryesues i mbledhjes së KQZ-së:

Kreshnik Radoniqi: Hapi mbledhjen e parë të këtij viti të ri, ju uroj këtë vit. Agjenda është kjo që e keni, dhe pastaj janë në radhë procesverbalet.

Në vazhdim, anëtarët e KQZ –së, me 9 vota për, miratuan rendin e ditës dhe procesverbalet nr. 41, 42 dhe 43/2022.

2. Aktivitetet e SKQZ-së

Burim Ahmetaj, tha fillimisht se buxheti për KQZ është ndarë – miratuar. Pastaj, ai tha se në harmonizim me autorizimet e nenit 66.5 të Ligjit nr. 03/L-073 për Zgjedhjet e Përgjithshme dhe Udhëzimin Administrativ të KQZ-së Nr.02/2022, për Menaxhimin e Pasurisë Jo financiare të KQZ-së, me datë 5 dhjetor 2022 është formuar komisioni për inventarizimin e pasurisë jo financiare. Detyrë e komisionit është që të regjistrojë gjithë pasurinë jo financiare: Inventarizimi i të gjithë pasurisë jo financiare që është në pronësi dhe në kontroll të KQZ-së; Verifikimi fizik dhe cilësor i gjendjes së pasurisë jo financiare; Krahasimi i gjendjes të inventarizuar me gjendjen në regjistrat e pasurive jo financiare; Identifikimi i pasurisë që nuk ka vlerë të bartur; Identifikimi i pasurive të dëmtuara dhe jashtë përdorimit; Përgatitja e raportit për kryerjen e inventarizimit; Hartimi i raportit të përgjithshëm në bazë të raporteve individuale të Komisionit për Inventarizimin e Pasurisë jo Financiare duhet të bëhet në kohën e përshtatshme para përgatitjes së pasqyrave financiare vjetore. Raporti i inventarizimit duhet të përmbajë gjendjen fizike të pasurisë jo financiare, kushtet e ruajtjes së tyre dhe vërejtjet mbi karakterin e diferencave dhe dëmtimeve të konstatuara.

Komisioni për inventarizim ka regjistruar inventarin dhe ka përgatitur Raportin e Inventarizimit me datë 04 janar 2023, dhe se pas këtij procesi, Sekretariati do të formojë komisionin e vlerësimit të pasurisë jo financiare të KQZ-së.

Sekretariati ka përgatitur Raportin për donacion dhe në Mbledhjen e fundit në muajin dhjetor 2022, ka njoftuar KQZ-në se cilave Organizata do tu dhurohen pajisjet të cilat KQZ nuk i ka në përdorim. Para se tu dhurohen pajisjet, është nevojitur të kontrollohen teknikisht dhe te përgatitet lista me numër serik për secilën pajisje që dhurohet. Deri me tani janë kontrolluar 605 tabletë dhe kanë mbetur pa u kontrolluar edhe 24 pako me nga 10 tabletë.

Z. Ahmetaj, tha se brenda pesëmbëdhjetë (15) ditëve pas shpalljes së legjislacionit mbi përvetësimet për një vit fiskal, , çdo autoritet kontraktues do të përgatisë planifikim përfundimtar të Prokurimit dhe duhet t'i dorëzojë AQP-së, një planifikim përfundimtar me shkrim që ti identifikojë me detale të arsyeshme të gjitha furnizimet, shërbimet dhe punët që autoriteti kontraktues synon ti prokurojë gjatë vitit fiskal bazuar në Buxhetin e miratuar për KQZ. Lidhur me këtë, Sekretariati ka draftuar planifikim përfundimtar të Prokurimit.

Gjithashtu, sekretariati i Komisionit Qendror të Zgjedhjeve në kuadër të zbatimit të aktiviteteve të draft Planit të Punës së KQZ-së për vitin 2023 është duke zhvilluar aktivitete: Përgatitja e planit përfundimtar të prokurimit, Planin i rekrutimit për vitin 2023, Plani Strategjik i KQZ- 2023-2026 i cili parashihet të kompletohet në javën e fundit të muajit shkurt 2023, Vlerësimin e Pasurisë Jo financiare të KQZ-së, Raportin përfundimtar i zbatimit të Planit të Punës së KQZ-së për Vitin 2022 së bashku me pasqyrat financiare, Organizimimi për shënimin e Ditës Globale të Zgjedhjeve që do të mbahet me 2 mars 2023, Planin Operacional për zgjedhjet e jashtëzakonshme për Kryetar Komune në Mitrovicë e Veriut, Zveçan, Leposaviq dhe Zubin Potok dhe Zgjedhjeve të Parakohshme për Kuvendin Komunal në Zveçan dhe Leposaviq që do të mbahen me 23 Prill 2023; Plani i angazhimit të stafit jo permanent për këto zgjedhje, zhvillimi i procedurave për furnizime dhe shërbime për këto zgjedhje.

Në fund, z. Ahmetaj tha se tek kontratat e nënshkruara për këto zgjedhje, Operatorët Ekonomik janë pajtuar me kohëzgjatjen e kontratës që furnizimet dhe shërbimet të realizohen në kohën kur KQZ organizon zgjedhjet.

3. Raport nga ZRCKFSP

Miratimi i vendimit për ndarjen e Fondit për mbështetjen e subjekteve politike për vitin 2023:

Besnik Buzhala, drejtor i ZRCKFSP tha se në bazë autorizimeve rregullative, KQZ merr vendime për ndarjen e mjeteve për mbështetjen e aktiviteteve të rregullta të subjekteve politike. Lidhur me këtë është vendimi për caktimin e lartësisë së mjeteve për këtë vit. Vlera totale e mjeteve, është: 4 milion e 200 mijë euro. Për këtë KQZ, duhet të marrë vendim në përputhje edhe me ligjin mbi financimin e subjekteve politike. Vlera për secilin subjekt, është e përcaktuar...

Lidhur me këtë pikë, diskutuan: Arnanit Elshani, tha se fondi do duhej të reflektonte buxhetin e vendit, dhe krahas kësaj të rritet edhe buxheti për partitë. Sami Hamiti, tha se në planifikimin tonë të buxhetit, kemi kërkuar rritjen për 10%, mirëpo nuk është akseptuar kërkesa jonë. Për vitin e ardhshëm, mundemi prapë me kërkue, ose mund të rritet vetëm me rishikim të buxhetit...

Më tej, u diskutue rreth relacioneve lidhur me lëvizjen e debutetëve përgjatë legjislaturës gjë që kjo, ndikon në rishikim edhe njëherë të fondit...Lidhur me këtë pikë, diskutuan: Sami Kurteshi, Besnik Buzhala, Sami Hamiti, Kreshnik Radoniqi, Arianit Elshani.

Në fund, anëtarët e KQZ-së kërkuan që të rishikohet edhe njëherë çështja e fundit.

4. Raportet e Këshillave të KQZ-së

Këshilli për Operacione Zgjedhore

1. Shqyrtimi dhe miratimi i Strategjisë për Edukim dhe Informimin e Votuesve në vitet jo Zgjedhore:

Arianit Elshani, tha se Sekrterariati ka krijuar një strategji në këtë drejtim. Aktivitetet janë të listuara gjë që, disa aktivitete do jenë edhe në planin e punës. Ne, rekomandojmë miratimin...

Anëtarët e KQZ-së, me 9 vota për u miratua strategjia për edukim dhe informim të votuesve për vitet jo zgjedhore.

2. Shqyrtimi dhe miratimi i Planit të Punës së KQZ-së për vitin 2023:

Arianit Elshani, tha se KOZ ka marrë draftin e planit të punës. Janë të parapra të realizohen 59 aktivitete. Z. Elshani, kujtoi edhe njëherë pikat më të rëndësishme të planit. Ai tha se plani nuk ka ndryshme, vec afateve të zbatimit....

Rreth çështjes së rregullave zgjedhore, Sami Kurteshi propozoi që të punohet dy – tri ditë, dhe të përfundohen rregullat....

Anëtarët e KQZ-së, e miratuan me 9 vota planin e punës së KQZ-së për vitin 2023.

3. Shqyrtimi dhe miratimi i projektit: Dita Globale e Zgjedhjeve, Agjendës dhe Ftesës:

Arianit Elshani: KOZ, ka shqyrtuar edhe aktivitetin mbi shënimin e ditës globale të zgjedhjeve dhe se, është paraparë të mbahen të mbahet një konferencë, dhe aktivitete të tjera. Është lista e të ftuarëve, dhe agjenda e ditëve 2 – 3 shkurt.

Është buxheti i alokuar, nuk e di nëse është i mjaftueshëm, por ne rekomandojmë miratimin.

Në këtë pikë, diskutuan: Sami Kurteshi, Arianit Elshani, Sami Hamiti.

Anëtarët e KQZ-së, e miratuan me 9 vota këtë projekt.

4. Shqyrtimi dhe miratimi i Kalendarit të aktiviteteve për hartimin e Planit Strategjik 2023-2026:

Arianit Elshani, ka shqyrtuar kërkesën e Sekretariatit për “kalendarin e aktiviteteve për hartimin e planit strategjik 2023-2026” ku pas afatit të përcaktuar për 20 shkurt, është kërkuar që të shtyhet edhe për shtatë ditë, domethënë deri më 27 shkurt.

Gjatë debatit, u kërkuar të dihet pse duhet të shtyhet afati, ndërsa kryeshefi z. Ahmetaj tha se është kërkuar për shkak të aktiviteteve të shumta që janë gjatë muajit janar, dhe më tej...

Ndërsa, lidhur me mbajtjen e një punëtorie në muajin janar, Ahmetaj tha se data më e përshtatshme do të ishte data 25 janar.

Anëtarët e KQZ-së, e miratuan me 9 vota u miratua kalendari i aktiviteteve për hartimin e planit strategjik 2023-2026.

5. Këshilli për Çështje Ligjore

Shqyrtimi dhe miratimi i kërkesës për zëvendësim të anëtarit të Kuvendit Komunal në Prishtinë dhe Suharekë:

Sami Hamiti, tha se këshilli është shqyrtuar kërkesa e kuvendit komunal të Prishtinës dhe se, nga Lëvizja VV, ka dhanë dorëheqje për shkak të marrjes së një pozite tjetër, Arbër Zeka dhe atë e zëvendëson Faton Zeneli. Janë plotësua kushtet, dhe e rekomandojmë për zëvendësim.

Kreshnik Radoniqi: Me 8 vota për, miratohet.

Sami Hamiti: Po ashtu, me kërkesën e kuvendit komunal të Suharekës, asamblisti Driton Maliqi që është zgjedhur në një funksion tjetër ka dhënë dorëheqje, kështu ai zëvendësohet nga Vullnet Luzhnica.

Kreshnik Radoniqi: Me 8 vota për, miratohet.

Të ndryshme !

Kreshnik Radoniqi: Kam mendue se gjatë kësaj jave duhet të takohemi dhe t'i shohim edhe njëherë rregullat, të gjitha, dhe për miratim t'i kemi në javën tjetër. Parimisht, jemi pajtue për të gjitha dispozitat. A pajtoheni që në këto tri ditë, ti shohim të gjitha rregullat ve atyre të zyrave, dhe ti trajtojmë të 18 rregullat... Të fillojmë që nesër...

Diskutuan: Kreshnik Radoniqi, Sami Kurteshi, Arianit Elshani, Ilir Gashi, dhe Čemailj Kurtiš.

U vendos që të enjten, të premten dhe të hënën e ardhshme të shqyrtohen rregullat – përfundimisht...

Kreshnik Radoniqi: Ju informoj se Presidenca e ka dërguar vendimin për ndërprerjen e mandatit Alim Rames..

Edhe për rregullat e brendshme, a duhet ta kemi një grup punues...? Edhe kjo, të bëhet sa më parë...